



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 26/2010

Prishtinë, 29. 06. 2010, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Mursel Haljilji,
Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari, Adem Salihaj, Mufëra Şinik dhe Qamile Morina.

Munguan: Zef Morina, Adem Grabovci dhe Fatmir Rexhepi.

Pjesëmarrës të tjerë: Hashim Rexhepi dhe Gani Gërguri – BQK, Sanije Berisha –
OSBE, Mehdi Pllashniku – MTI dhe Besnik Ramadanaj – KDI.

Stafi Mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj, Muhamet Morina,
Besim Haliti dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të 22. 06. 2010;
3. Politikat bankare të Bankës Qendrore të Kosovës - BQK;
Të ftuar: z. Gazmend Luboteni, kryesues i Bordit të BQK - së dhe z. Hashim
Rexhepi, guvernator i BQK - së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për
shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 22. 06. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 22. 06. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Politikat bankare të Bankës Qendrore të Kosovës - BQK;

Të ftuar: z. Gazmend Luboteni, kryesues i Bordit të BQK-së dhe z. Hashim Rexhepi, guvernator i BQK - së;

Kryetarja – Theksoi se sot është i pranishëm z. Hashim Rexhepi, guvernator i BQK - së, për të raportuar para Komisionit për “Politikat bankare të Bankës Qendrore të Kosovës – BQK- së dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit”. Fjalën ia dha z. Rexhepi.

Hashim Rexhepi (Guvernator i BQK - së) – Tha se bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, objektivat kryesore të BQK - së janë siguri i stabilitetit të sektorit financiar dhe mbështetja e politikave të përgjithshme ekonomike në vend. BQK - ja ka autoritet rregullator dhe zbatues për të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë. Rregullat e BQK - së janë në përputhje me standardet e BE - së dhe i janë përshtatur nivelit të zhvillimit të institucioneve financiare që operojnë në Kosovë. BQK zbaton funksionin e rregullatorit të sektorit bankar bazuar në 31 Rregulla Bankare, të cilat në mes tjerash përfshijnë rregullën për mjaftueshmërinë e kapitalit, rregullën për koncentrimin e kredive, rregullën për mbajtjen e mjeteve likuide, rregullën për qeverisjen e bankave, etj. Po ashtu, përmes “Letrave Këshilluese”, BQK- ja udhëzon institucionet financiare për implementimin e “praktikave më të mira”. Gjatë vitit 2009, BQK- ja aprovoi letrat këshilluese të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, si dhe politikën e licencimit mbi shqyrtimin e historikut të personave dhe kompanive të caktuara që janë të interesuara të hyjnë në sistemin financiar të Kosovës. BQK- ja ka autoritetin për të vendosur standardet për licencimin e institucioneve financiare dhe revokimin e licencave në rastet kur veprimtaria e institucioneve financiare nuk është në pajtim me rregullat në fuqi. Në këtë mënyrë, BQK- ja përcakton edhe kushtet konkurruese në sistemin financiar të Kosovës. Përmes ekzaminimeve nga jashtë dhe ekzaminimeve në vend, BQK siguron që institucionet financiare zbatojnë rregullat përkatëse, duke i kontribuar kështu zhvillimit të një sektori të shëndoshë financiar, që i është i aftë të absorbojë tronditjet e mundshme dhe t'i kontribuojë zhvillimit ekonomik të vendit. BQK- ja është kompetente për furnizimin e ekonomisë vendore me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme. BQK- ja ofron shërbimet bankare për Thesarin dhe institucionet e tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërmarrjet publike, institucionet financiare dhe

organizatat ndërkombëtare. Këto shërbime kryesisht kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e llogarive dhe kryerjen e pagesave, duke përjashtuar çdo formë të kreditimit. BQK – ja është e autorizuar të veprojë si agjent fiskal i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe, po ashtu, është e autorizuar të investojë mjetet e Qeverisë. Fondet e depozituara në BQK kryesisht i takojnë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (rezervat buxhetore) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Investimi i mjeteve bëhet në pajtim me Politikën Investive të miratuar nga Bordi drejtues i BQK - së, duke i dhënë rëndësi të veçantë sigurisë, likuiditetit dhe kthimit në investime. BQK - ja ka zhvilluar një sistem modern të pagesave ndërbankare, duke i kontribuar kështu funksionimit efikas të transaksioneve elektronike, gjë që i kontribuon zvogëlimit të përdorimit të parasë së gatshme në ekonomi, me implikime pozitive për rritjen e depozitave dhe po ashtu për zvogëlimin e ekonomisë joformale në vend. BQK - ja në vazhdimësi ka zhvilluar produkte të reja, siç janë skema Kos - Giro dhe skema e debitimit direkt, të cilat kanë për synim rritjen e kanalizimit të transaksioneve përmes sistemit bankar. Në përputhje me synimet për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për një funksionim sa më efikas dhe të sigurt të sistemit financiar, BQK-ja ka krijuar Regjistrin e Kredive të Kosovës që mundëson shkëmbimin e informacioneve kreditore ndërmjet institucioneve financiare, duke promovuar kështu kreditimin e shëndoshë dhe stabilitetin e përgjithshëm të sektorit financiar. Në kontekst të funksionit statistikor, BQK - ja ka arritur standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në fushën e statistikave monetare dhe financiare, si dhe të bilancit të pagesave, duke i kontribuar kështu informimit adekuat të publikut për zhvillimet në sektorët përkatës të ekonomisë. Për më tepër, BQK - ja përpilon analiza periodike dhe joperiodike mbi zhvillimet në ekonominë e vendit, me fokus të veçantë në sektorin financiar. Angazhimi i BQK - së ka rezultuar në krijimin e kushteve të përshtatshme për funksionimin normal të sektorit bankar, duke rezultuar kështu në një sektor stabil që ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Sektori bankar i Kosovës është plotësisht në pronësi private. Kreditë e lëshuara nga sistemi bankar kanë ndjekur rritje të vazhdueshme që nga fillimi i funksionimit të këtij sektori, duke arritur në rreth 35 për qind të PBB – së. Pjesa më e madhe e kredive të sektorit bankar i është lëshuar ndërmarrjeve, gjë që reflekton përkrahjen e sektorin bankar për zhvillimin e biznesit në vend. Si pasojë e mungesës së instrumenteve tradicionale të politikës monetare, që buron nga adaptimi i euros si valutë zyrtare, BQK- ja është e kufizuar në kuptim të ndikimit në kushtet e kreditimit në vend. Sidoqoftë, BQK - ja në vazhdimësi ka krijuar kushtet për rritjen e konkurrencës së shëndoshë në sistemin bankar, gjë që është reflektuar në kosto dhe shërbime më të favorshme për klientët e bankave komerciale. Në këtë aspekt, politika licencuese liberale e BQK - së ka kontribuar në sjelljen e bankave me renome ndërkombëtare në Kosovë, të cilat kanë sjellë me vete praktikatat më të mira të veprimtarisë bankare. Mungesave e instrumenteve tradicionale të politikës monetare, të cilat do të mund të shfrytëzoheshin për përkrahjen e institucioneve financiare në rast të vështirësive të paraqitura, ka shtyrë BQK - në të zbatojë politika më konzervative të vlerësimit të rrezikut në sektorin bankar. Si rezultat, sektori bankar i Kosovës ka një portfolio të shëndoshë kreditore, me një pjesëmarrje relativisht të ulët të kredive të këqija dhe nivel të kënaqshëm të kapitalizimit dhe likuiditetit.

Kaqusha Jashari – Paraqiti vërejtje së mbledhja nuk është përgatitur si duhet të

diskutohet për politikat bankare dhe ndikimi i tyre në Kosovë, pa diskutuar për Raportin për vitin e kaluar, sepse është dashur të diskutohen së bashku. Duke e dëgjuar referimin e guvernatorit lidhur me politikat bankare ka përmendur se cilat janë ato obligime bazuar me Ligj, dhe kërkoj dy sqarime si pyetje, nën një për mbështetjen e zhvillimit ekonomik që ka Banka Qendrore dhe nën dy për Mbikëqyrjen e Bankave. Sa për mbështetjen e zhvillimit ekonomik banka duhet të angazhohet në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Prandaj pyeti se si mundet Banka dhe në çfarë mënyre deri më tani e ka mbështet zhvillimin ekonomik, sepse në bazë të raportimit tuaj 3.8% është rritja ekonomike d.m.th. në krahasim me të tjerët është shumë mirë, por është edhe një pyetje se si ka mundur me qenë mbështetja? Kjo pyetje vjen, veprimtaria është bazuar në depozitat e qytetarëve, ndërsa kryesisht kamatat janë shumë të larta për ekonominë për biznese dhe ato mund të merren me garancion, po ashtu hipoteka. Zonja Jashari shtoi se Banka Agrare ka mundur të jetë një ndër bankat për zhvillimin e bujqësisë ose bankat tjera në funksion të zhvillimit ekonomik, e jo bankat komerciale me qenë aty, e ngulfatin pastaj tërë sistemin. Jeni të autorizuar ta menaxhoni nga Qeveria fondin në rezerva buxhetore, kemi këtu edhe Agjencinë e privatizimit. Për herë të parë këtu po shihet qartë që politikat investimeve janë miratuar nga Bordi drejtues i Bankës Qendrore. Prandaj shihet qartë se Banka Qendrore është ajo e cila ka plasuar mjete e nuk është që nuk dihet adresa, si jepet në opinion. Gjithashtu është e paqartë në lidhje me mbikëqyrjen të bankave, jo edhe subjekteve të tjera, sepse ju thatë që po i mbikëqyrni dy fonde pensionale.

Kryetarja – Sqaroi se Raporti i BQK - së, diskutohet për Komisionin për Buxhet dhe Financa, ndërsa Vendimi i Komisionit për Ekonomi ka qenë të diskutohet këtu vetëm lidhur me politikat bankare dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik në Kosovë.

Ethem Çeku – Tha se realisht sot kemi dashur të diskutohet rreth ndikimeve që i ka sektori bankar në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, d.m.th. fokusi të jetë në atë që e kemi biseduar, është se si ndikon edhe cilat janë implikimet dhe trendët e sistemit bankar në zhvillimin ekonomik. Nga të gjithë parametrat tonë, të cilat edhe janë bërë publike, e kemi parë se kemi një trend shumë të ngadalshëm të zhvillimit ekonomik duke marrë për bazë edhe shkallën e zhvillimit, sepse duhet të nisët nga shkalla e zhvillimit nga forma se sa kemi shkuar përpara. Ne e kemi një material të shkruar edhe pse është sjellë më vonësë, kemi edhe Raportin Vjetor, por megjithatë këtu janë dhënë disa përshkrime të funksionit të bankës që unë besoj kolegët deputet e kanë vizionin për punën dhe kompetencat që i ka Banka. Çështjen e parë që ngriti ishte se a mund të jenë rregullatorë të sistemit bankar financiar, a kemi monopolizëm në sistemin e kamatave, sepse është vendos sistem monopolistë në sistemin bankar të Kosovës rreth çështjes së kamatave. Edhe pse kamatat përcaktohen realisht nga ekonomia, nga tregu. Edhe sa i përket çështjeve të garancioneve, mendoj se kreditë e këqija në raport me vendet e tjera Kosova është në raport më të mirë dhe a është e saktë që Kosova ka numrin më të vogël të kredive të këqija? A është e saktë që në Kosovë kamatat janë më të larta në krahasim me të gjitha të rajonet? A është e vërtet që depozitat e qytetarëve tanë janë më të ulëta në krahasim me depozitat e qytetarëve të rajoneve tjera? Dhe të gjitha këto politika a janë në favor dhe sa e ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit tonë? Sa i përket infrastrukturës ligjore sistemit të gjykatës, kur dihet se një qytetar për të tërhequr kredi së paku duhet të lënë peng, hipotekë të them kushtimisht 1/3 e vlerës së kërkuar, sepse në çfarë do forme

ai i jep garancion të jashtëzakonshëm për tërheqjen e kredive d.m.th. këto janë çështje që neve, si Komision, na kanë interesuar. Sa i përket rritjeve të eksporteve realisht nuk e di se ku janë ato 40 % të eksporteve, kur e dimë se kemi problemin e CEFTA-ës dhe mbylljen e eksporteve në drejtim të vendeve të rajonit. Mirëpo nuk po na funksionojnë sistemet e ekonomive të cilët më herët e kanë bartur zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Mendoj se realisht pres një ekonomi shumë më dinamike nga ana juaj duke e ditur se ne nuk kemi politika monetare, sepse jemi në sistemin e eurozonës. Mirëpo mendoj se vendet, kur po flasim për perceptcionin e brisqeve, kosovarët me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, me krijimin e institucioneve duhet dalë nga koncepti i rrisqeve që po na kushton shumë shtrenjtë. Në fund bëri thirrje që BQK - ja të jetë shumë më azhure, posaçërisht në vendosjen e autoritetit në sistemin rregullator dhe në sistemin kreditor dhe duke mos e eliminuar sistemin e ekonomisë të tregut, për ruajtjen e sistemit të konkurrencës, sepse po krijohen edhe sisteme monopoliste në fushën bankare.

Qamile Morina - Konsideroj se është një temë mjaft e rëndësishme të diskutohet duke e marrë parasysh se ne të gjithë nuk jemi ekonomistë dhe nuk mundemi ta absorbojmë këtë në dy - tre minuta e pastaj të diskutojmë seriozisht. Paraqiti vërejtje serioze në mënyrë që të mos jetë kjo çështje e promovimit medial. Pastaj paraqiti pyetjet: meqenëse ju jeni në mbikëqyrjen e pensioneve edhe ka të bëjë me Trustin pensional, sa është e ditur Trusti ka pësuar humbje diku prej 17 deri 19 milionë euro, ndërsa interesi është se cilat do të jenë hapat e bankës që mos të na ndodh si në vitin e kaluar, si dhe pse po ndodhin këto trende dhe çka duhet ju të propozoni që të sigurohen mjetet e qytetarëve tanë, sepse ky Trust është trust detyrues? Pyetja tjetër është rritja e depozitave në krahasim me rritjen e kredive, vështirë mund të thuhet se ju në njëfarë mënyre e përkrahni zhvillimin ekonomik, ndërsa të hollat të mrizojnë në BQK, atëherë gjithmonë do t'i kemi të larta normat e interesit të kredive dhe kjo do të jetë shumë e disfavorshme për zhvillimin ekonomik. E dyta është se nëse ato të holla po mrizojnë prapë, ju nuk keni siguri që t'i keni në tregun kosovar, atëherë shtrohet pyetja se si mund t'i bindim investitorët e huaj që ata të kenë siguri në tregun kosovar? Pyetja tjetër, a parashihet të merret kredi, kur dihet se është nënshkruar Projekti Vermicë – Mërdare, a parasheh BQK-ja të merr kredi dhe si mendon ta përmbush? Dhe nga raporti i juaj shihet se në këtë vit Buxheti jonë do të jetë në gjendje të disfavorshme, duke pasur parasysh se do të jetë në deficit prej 100 e 27 milionë dhe këto do të përmbushen me hua dhe këto hua llogaritet që do të jenë 15 % interesi i borxhit d.m.th. a janë këto me të vërtetë politika të qëlluara bankare?

Kryetarja – Duke e marrë parasysh se në mbledhjen e kaluar nuk ishit të pranishëm nuk është detyrë as e kryetares, as e Stafit Mbështetës, që t'ju përgatit se si do të vini në mbledhje. Mirëpo Raporti i BQK - së ka qenë në kutit tuaja, pra Raporti është shpërndarë dhe nuk mundemi të jemi ekspertë për secilin deputet.

Adem Salihaj - Theksoj se e dëgjuam me vëmendje fjalën e guvernatorit dhe ishin shifra shumë inkurajuese dhe të gjitha ato që i dëgjuam dhe shpresojmë që edhe realiteti të jetë kështu. Ne kemi një ngecje të zhvillimit ekonomik dhe ndoshta janë faktorët realë që kanë ndikuar në situatë në të cilat kemi kaluar dhe deri diku duhet ta marrim si normale. Pyeti se rritjen e interesimit për kredi prej 15% në vit a duhet ta marrim si një shenjë të zhvillimit ekonomik apo duhet ta marrim si një shenjë të krizës ekonomike në Kosovë?

Sepse ndoshta shumë ndërmarrje ose firma që janë në krizë ekonomike dhe nuk gjejnë zgjidhje të tjera hyjnë në kredi të cilat për shkak të kamatave shumë të larta, pastaj fundosën në tërësi d.m.th. duhet ta analizojmë se cili aspekt është këtu arsyeja që ato marrin kredi dhe ecin mirë apo është arsyeja që përmes kredisë mundohen që të shpëtohen. Dhe nganjëherë ndodh e kundërta e asaj dhe në anën tjetër sa ka mundësi edhe Banka Qendrore, por edhe ne, si Parlament i Kosovës, të ndikojmë në normën e uljeve të kamatave, nëse ka mundësi të rregullohet kjo në forma institucionale dhe shtetërore, sepse duhet ta shohim këtë mundësi ku BQK-ja duhet të na propozoj zgjidhjen në këtë drejtim. Nuk e di sa mundet me qenë reale shifra prej 40 % të rritjes së eksportit, sepse në praktikë nuk duket kështu, po me qenë se ne nuk jemi ekspertë dhe nuk i kemi shifrat, nuk po arrijmë t'i kontestojmë këto. Dhe në fund tha se më rendësi është se si është e rregulluar çështja e imitimit të parave duke e marrë parasysh se kemi një rritje të vogël ekonomike, por Kosova nuk mund të emitojë para, gjë që kjo dihet dhe si rregullohet kjo çështje në tregun tonë?

Kryetarja – Në Raportin tuaj përshkruhen të hyrat dhe të dalat, depozitat në para të gatshme, tërheqjet e parave të gatshme, transferet vendore, transferet dalëse që është roli i BQK- së i përcaktuar me Ligjin për Bankat Qendrore. Mirëpo ju, si rregullatorë i bankave ekonomike edhe komerciale është dashtë të tregoni pjesën ku nuk mund të implementohet çështja e uljes së kamatave, ndoshta edhe për bizneset e jashtme të cilat dëshirojnë të zhvillojnë një biznes në Kosovë. Duke marrë parasysh të dhënat tuaja për rritjen ekonomike apo bruto produktin vendor të Kosovës, shihet se Kosova është në zhvillim shumë të ulët ekonomik, ndoshta edhe investimet për në Kosovë. Ndoshta kishte mundur me qenë edhe huamarrja për bizneset e vogla dhe të mesme me një kamatë shumë të volitshme. Nga kolegët deputet u potencua edhe çështja e eksportit dhe importit në Kosovë, që është në shkallë krejtësisht të ndryshme që do të thotë se Kosova më shumë importon se sa eksporton dhe dihet se në çfarë bllokade jemi ne, si shtet i ri, i cili ka bllokada edhe nga fqinjët, siç është rasti me Serbinë dhe Bosnjën, por kemi edhe rënje të remitancave. Ju e keni potencuar mirë edhe në Raportin tuaj se është çështja e kontrollit të Institucioneve mikrofinanciare të cilat mund të quhen edhe si institucione piramidale, të cilat janë zhvilluar me një kohë në Republikën e Shqipërisë, se në fillim kanë qenë në çështjen e OJQ - ve, dhe tash kërkoj nga ju, si autoritet më i lartë dhe duhet që këto të kontrollohen dhe t'i nënshtrohen Ligjit dhe kjo është e vetmja mundësi çdo gjë të ndalohet përmes Ligjit. Dhe një pyetje shumë me rëndësi duke e shqyrtuar çështjen e buxhetit 2010 në rishqyrtim të buxhetit hasa në kthimin e mjeteve të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, nuk dihet se si është e mundur të merret ai vendim dhe të pasqyrohet brenda buxhetit 2010? Në rast se ju, si autoritet bankar, vetëm bëni transferin në institucione bankare, ku e shihni çështjen e interesit në ato institucione, kur dihet se ne e kemi mungesën e Ligjit për letrat me vlerë? Kjo na kushton mjaft në çështjen e aksioneve të kthimit të parave dhe a është marrë një vendim nga BQK-ja që ato para të kthehen dhe të vendosen në buxhetin e Kosovës apo vetëm figurojnë aty?

Hashim Rexhepi (Guvernator i BQK- së) – Duke u përgjigjur në pyetje të deputetëve tha se rritja e eksporteve në tre mujorin e parë të këtij viti në raport me tremujorin e parë të vitit të kaluar ka të bëjë me këtë rritje, për shkak të participimit ose nivelit të eksporteve të Kosovës që mbulojnë rreth 10% të importeve të përgjithshme normal që e

shohim si një shenjë inkurajues. Ka ndikuar rritja e kërkesës në tregun ndërkombëtarë, faktori dominues në këto eksporte ka qenë “Ferronikeli” së bashku me eksportet e metaleve hedhurina. Konsideroj që çështje shumë serioze është çështja e CEFTA- s, ku shumë biznese në Kosovë janë dëmtuar seriozisht për shkak të pamundësisë së eksporteve të tyre në Serbi, Bosnje ose kalimit përmes këtyre territoreve, duke filluar prej industrisë së verërave, plastikës e kështu me radhë. Z. Çeku parashtroi disa pyetje shumë fundamentale të karakterit zhvillimor të politikave në të cilat ne, si bankë, e shohim rolin tonë aktiv dhe normal dëshirojmë të kontribuojmë në këto politika edhe pse me ligjin e Bankës Qendrore të Kosovës janë të përcaktuara strikt funksionet dhe përgjegjësitë e Bankës Qendrore. Znj. Kaqusha hapi çështjen e sektorit komercial bankar, normal që bankat komerciale si bëjnë biznes sikurse të gjitha bizneset e tjera, mirëpo ato biznese kanë para në krahasim me bizneset e tjera që kanë mallra të tjera dhe më tepër kanë profite, dhe detyra jonë është që ato institucione të operojnë në pajtim me rregullat që ka BQK- ja, dhe jep ligji. Ne nuk bëjmë politika në kuptimin e asaj se çfarë banka dëshirojmë të licencojmë, hyrja dhe dalja në sistemin bankar është e hapur në bazë të ligjeve në fuqi, kështu që nuk mund të themi se duhet ta licencojmë një bankë agrare dhe ta përgatisim aplikacionin për një bankë agrare, apo ta përgatitim dikë të aplikojë për bankë investive, çështja është e palëve të interesuara a dëshirojnë të aplikojnë për një lloj të tillë të biznesit, sepse do të ishte konflikt i tmerrshëm i interesit dhe do të involvonte BQK- në në diçka që nuk është në përgjegjësi të saj. Për fat të keq deri më sot ne nuk kemi pasur asnjë aplikacion të kësaj natyre të bankës agrare, të bankës investive ose qoftë bankës zhvillimore të Kosovës. Sipas ligjit BQK - ja menaxhon buxhetin, menaxhon mjetet e institucioneve publike, duke përfshirë AKP - në dhe rezervat e detyrueshme të bankave që mbahen në bankën qendrore të Kosovës, si dhe një pjesë të kapitalit të kompanive të sigurimit. Me ligj Banka Qendrore e ka të ndaluar që të investojë në banka komerciale dhe që të financojë buxhetin e shtetit, e vetmja mundësi që i lejohet Bankës Qendrore me qëllim të menaxhimit me nikoqirllëk të mjeteve që janë sipas ligjit në llogari të saj është që të investojmë jashtë. Në ligj përcaktohen principet kryesore se si investohen këto mjete, ndërsa Bordi i Bankës Qendrore ka aprovuar një politikë investive të cilën ne, si menaxhment, e respektojmë në tërësi dhe e implementojmë me të gjithë atë çka e parasheh politika investive. Meqenëse këto janë mjete publike principi i parë që përkujdesemi ne gjatë investimeve të mjeteve është siguria e investimeve. Ne punojmë kryesisht me bankat qendrore me të cilët kemi arritur të kemi marrëveshje - memorandumet për shkak se kemi një problem shumë serioz, për shkak se është mungesa e SWIFT KODIT për Kosovën. Ne nuk bëjmë pagesa elektronike me sisteme të avancuara elektronike që punojnë në Evropë, ne pagesat sot i bëjmë ende me faks. Prandaj ne kemi arritur me këto kushte të kemi marrëdhënie të mira me Bankën Qendrore të Gjermanisë, të Francës, të Luxemburgut dhe të Austrisë etj.

Kryetarja – Pyeti se kur do të sigurohet ky Kod?

Hashim Rexhepi (Guvernator i BQK- së) – Ne kemi bërë një politikë shumë aktive në këtë drejtim gjatë tërë kohës, z. Gani Koci para pak kohe ka qenë edhe në Frankfurt që të shohim mundësinë e negociimit dhe gjetjes së zgjidhjes, përgjigjja përfundimtare prapë është kjo për shkak se Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Neve na kanë ofruar një zgjidhje kalimtare përdërisa Kosova nuk e rregullon këtë status, mirëpo

meqenëse ka të bëjë me çështje të natyrës politike, ne jemi duke pritur përgjigje nga qeveria të hyjmë në aranzhmane kalimtare ose të presim derisa të rregullohet statusi, e njëjta gjë ka ndodhur edhe me kartonin e gjelbër për qarkullimin e lirë të qytetarëve që siguron sigurinë ndërkombëtare të autopërgjegjësisë. Ju keni qenë të shqetësuar dhe opinionin i gjerë për një debat i gjatë që ka qenë me AKP - në, përfundimisht çështja është kuptuar dhe është zgjidhur, ka qenë gjithnjë e zgjidhur dhe e qartë, AKP - ja i ka mjetet në BQK, ka mbi 900 llogari të gjitha ndërmarrjeve që janë shitur deri tani kanë mjetet në llogarinë e asaj ndërmarrje, ato mjete janë aktive dhe mjetet i mbajnë në llogarinë rrjedhëse, kështu që ne për çdo ditë për çdo transaksion dërgojmë një raport AKP- së për nevojat e tyre, për analizat e tyre. Çështja është qartësuar deri në fund normal si Bankë Qendrore në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës ne jemi të interesuar se si t'i gjejmë modalitetet eventuale që këto mjete të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik. Kështu që jemi dakorduar me AKP të kemi grupe të përbashkëta që minimum ata të kenë një politikë aktive investive, që mos të lejojmë mjetet në llogari rrjedhëse, por t'i afatizojmë në mënyrë që të mund të investojmë në instrumente financiare që të sigurojnë një kthim më të madh. Principi i dytë i politikës tonë investive është që të sigurojmë likuiditetin e depozitarëve tonë, atë ditë kur buxheti lyp paratë ne duhet t'i japim, atë ditë kur AKP- ja kërkon paratë, ajo duhet t'i ketë në diskonim. Ne që i kemi paratë tona në Bankat komerciale është principi i njëjtë, prandaj normalisht që investimet tona janë shumë të shkurta në instrumente shumë të sigurta financiare në mënyrë që të jenë në dispozicion të depozitarëve në momentin që i kërkon. Principi i tretë është norma e interesit, për shkak të parasë publike ne nuk mund të rrezikojmë në instrumente financiare ku ka fluturime në tregjet financiare dhe humbje eventuale të parasë. Edhe këtë informacion duhet ta jap, prej se ekziston BQK- ja deri më sot asnjëherë të vetme nuk kemi pasur një humbje të një centi në politikën tona investive, përkundrazi ka pasur momente kur tregjet financiare kanë funksionuar si duhet që kanë pas normë kthimi deri në 3.5%. Ne jemi agjent fiskal sipas rolit dhe ligjit për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe thesarin e Republikës së Kosovës. Ne kemi një komision të përbashkët që quhet Komisioni për likuiditet dhe takohemi në mënyrë të rregullt dhe përcaktojmë balancat e nevojshme në mënyrë që mjetet të jenë çdo herë në dispozicion sipas nevojave të tyre.

Ethem Çeku – Ju keni vendosur prioritet politikën e sigurisë, e para në mënyrë që ato fare të mos dëmtohen në aspektin financiar, dhe e dyta në politikën që deri diku ndoshta ka mundur ta sjellë edhe nga depozitat një të hyrë buxhetit të Kosovës. A mund të ketë politika më agresive tani në drejtim të përdorimit të këtyre dy fondeve? Sepse Ju e keni përmend se ndonjëherë na ka arritur 3.2, unë e di që ndonjëherë na ka arritur 0.6 edhe 0.1.

Hashim Rexhepi (Guvernator i BQK - së) – Ne kemi një zyrë të brendshme që merret me menaxhimin e riskut dhe në kontiunitet në baza ditore i vlerëson rrisqet në tregjet financiare, në bankat qendrore, në shtete në bankat me të cilat ne operojmë. Nga ajo që kemi parë çka ka ndodhur në Greqi, problemet me të cilat përballlet Spanja e potencialisht edhe Portugalia dhe Irlanda janë probleme të cilat kanë hapë disa pyetje shumë të rëndësishme në nivel të Komisionit Evropian, në nivel të Bankës Qendrore, në nivel të gjetjes së instrumenteve të tjera rregullative, në mënyrë që të sigurohet një standardizim i financave i politikave fiskale i monedhës. Kështu që në bazë të vlerësimit të ekspertit

tonë për vlerësimin e rriskut ne marrim vendime përkatëse, dhe të jeni të sigurt se asnjë investim pa vlerësim paraprak të ekspertit për rrisqet nuk bëhet, ashtu si do të evoluojë dalja nga kriza financiare e vendeve të Unionit Evropian, normal ne i lejojmë vetit një apetit ndoshta pak më të madh të rriskut në mënyrë që të sigurojmë një kthim më të mirë. Ne kemi të bëjmë me paratë publike dhe duhet të jemi të kujdesshëm dhe konsiderojmë që nuk është në rend të parë interesi sa është siguria e investimit të mjeteve, ne i përmbahemi këtij principi. Ju e dini që ligji për pensionet dhe BQK- ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen e Trustit të kursimeve pensionale dhe shtyllës së tretë të pensioneve në Kosovë që quhen pensione vullnetare. Në Kosovë ka vetëm një fond pensional vullnetar të licencuar dhe quhet Fondi sloveno - kosovar i pensionit, i cili ofron pensione shtesë për ata që dëshirojnë të kursejnë për pleqërinë e tyre kur dalin në pension për të marrë një pension më të qëndrueshëm. Trusti ka pas një periudhë të kthimeve jashtëzakonisht të mirë dhe normave të kthimit nga investimet kanë qenë rreth 14% në periudhën mars, - shkurt të vitit 2009 deri në mars të vitit 2010. Për shkak të krizave në tregjet financiare, në muajin e fundit trusti ka pasur kthime negative në disa nga investimet që ka të cilat aktualisht sillen rreth 17 milionë. Vlera e aksionit të trustit aktualisht ka ra në 0.97 kishte qenë 1.1 dhe ka dëshmuar atë se duhet të jemi të kujdesshëm në vendimmarrje.

Qamile Morina – Çka mund të bëni që të parandalohen humbjet eventuale nga trusti i kursimeve?

Hashim Rexhepi (Guvernator i BQK- së) - Kontribuesit e Trustit janë shumica të moshës së re, dhe politikat investive të Trustit janë relativisht afatgjata, dhe kthimet në investime në planin afatgjatë janë pozitive. Ne kemi filluar rishikimin e ligjit për pensionet në Kosovë, draftimi i ligjit veç është në fazën finale, kemi punuar shumë afër me ekspert të dalluar të pensioneve nga Banka Botërore dhe shumë shpejt do të procedohet në grupet ndërministrare, me vlerësimet dhe opinionet e veta, në mënyrë që të kemi një ligj shumë më të qartë dhe disa çështje të karakterit politik të diskutohen dhe t'i definojmë. Pyetjen që e bëri z. Çeku a ka monopol në sistemin e kamatave, nga mbikëqyrja jonë, nga inspektimet që i bëjmë nga komunikimi jonë nuk mund të konstatojmë se ka ndonjë marrëveshje në kuptim të monopolit në kamata. Problemi themelor aktualisht është se sistemin bankar e kemi relativisht të koncentruar në tri banka që kontrollojnë diku afër 80% të sistemit bankar. Çka mund të bëjmë ne si ta rrisim konkurrencën në sistemin bankar dhe të sigurojmë një konkurrencë të drejtë. Ne kemi bërë shumë në vitin 2006, 2007, 2008 që të atraktojmë licencimin e bankave të reja që i plotësojnë standardet, janë futur tri banka të reja në vitin 2007, 2008 në sistemin bankar. Në vitin 2009 ka pasur mjaft ardhje - shkuarje të palëve të interesuara, por vetëm një aplikacion e kemi aktualisht për licencim të bankës së re. Kriza financiare globale, aktorë të mëdhenj bankar nuk e kanë parë momentin e duhur për zgjerimin e aktivitetit të tyre në vendin e rajonit, por edhe në Kosovë. Ky është i vetmi instrument dhe vegël ku ne jemi duke punuar dhe kemi kontribuar që të rrisim konkurrueshmërinë në sistemin bankar, sigurisht i vëreni këto bankat e reja qoftë TEB- i apo BKT- ja kanë filluar të jenë aktor të rëndësishëm dhe janë duke ndikuar në mënyrë graduale në rënien e këtij koncentrimi dhe dhënien e ofertave më të volitshme krahasuar me bankat e mëdha. Pjesëmarrja e dy bankave që janë me kapital vendor në sistemin bankar janë diku me 7- 8%, që nënkupton se kanë një pjesëmarrje relativisht të vogël, mirëpo të dyja kanë një qëndrueshmëri të

mirë dhe ka një përmirësim të cilësisë së menaxhimit. Me gjithë vështirësitë kthimi i kredive në Kosovë është i qëndrueshëm, kreditë e këqija me probleme në Kosovë janë diku rreth 4.3%. Në Shqipëri kreditë e këqija aktualisht janë rreth 9% në vendet e rajonit sillen 6, 7, 8%. Bosnja është në nivel me neve ose diçka më mirë, që do të thotë se qytetarët e Kosovës kanë një kulturë të marrjes dhe kthimit të kredisë.

Kryetarja – Çështja e humbjes së vlerës së Trustit a kishte me qenë më e udhës që edhe vetë Komisioni për buxhet dhe financa dhe MEF - i të bëjnë draftimin e ligjit për Trustin pensional dhe atëherë ndoshta kish me qenë mundësia tjetër e kthimit të parave ndoshta edhe në banka ku ju i shihni më të sigurta.

Hashim Rexhepi (Guvernator i BQK- së) - Këto çështje janë në procedurë të drafimit të ligjit dhe janë në debat në komisionet ndërmministrorë. Znj. Qamile pyeti se a parasheh BQK të merr kredi për autostradë? BQK-ja nuk merr kredi, por Qeveria, pra është MEF-i dhe Qeveria që përcaktojnë politikat e kredimarrjes, kështu që BQK-ja do ta luan rolin e agjentit fiskal në implementimin e saj. Ne nuk llogarisim në kurrfarë kredie, por ajo varet prej implementimit të ligjit për ndërmarrjet publike dhe politikat qeveritare për kredimarrje.

Adem Salihaj – A ekziston ndonjë mundësi ligjore që mjetet e AKP - së dhe mjetet e Trustit t'i jepen si kredi Qeverisë së Kosovës?

Hashim Rexhepi (Guvernator i BQK - së) - Në momentin që Qeveria do të fillojë të emetojë instrumente financiare, gjegjësisht letra me vlerë, Trusti ka të drejtë që të investojë me një pjesë të konsiderueshme të mjeteve në "bonothesar" apo "bono-obligacione" që lëshon shteti që i garanton me buxhetin e Kosovës. Ne jemi agjentë fiskal prapë në implementimin e këtij ligji normal që pritet që të plotësohet legjislacioni sekondar nga ana e MEF – it, e cila do të definojë instrumentet financiare dhe sigurinë e tyre, do të rregullojë funksionimin e tregut primar të letrave me vlerë dhe pjesëmarrësit në tregun me letra me vlerë dhe do të zhvillojë legjislacionin sekondar për letrat me vlerë ku bëhet shitblerja e atyre instrumenteve ose varësisht prej kërkesave që i ka tregu. Ligji për huamarrje publike e rregullon këtë çështje dhe normal që janë të nevojshme aktet nënligjore të cilat rregullojnë pastaj specifikat nevojshme. BQK-ja ka mundësi të ofrojë kredi emergjence të likuiditetit në kushtet e rriskut të sistemit për bankat. Kemi tri kategori të bankave - Bankat universale ku përfshihen bankat komerciale dhe bankat investive dhe banka islamike, kategoria e dytë do të jenë bankat e kursimeve që do të kenë kërkesat e kapitalit pak më ndryshe dhe do të jetë më e limituar me produkte dhe kategoria e tretë do të jetë institucionet mikrofinanciare bankare.

Qamile Morina – Në vitin 2009 ka rënie në sistemin bankar, kush i ka kontribuar kësaj rënie të sistemit bankar?

Hashim Rexhepi (Guvernator i BQK- së) - BQK -ja me ligj është e detyruar që 10% nga totali i depozitave të tyre t'i mbajë në kesh që të mund t'i përgjigjet nevojave të tyre ditore. Fitimi i sistemit bankar në vitin 2009 ka rënë diku 30%. Arsyet për këtë rënie të profitabilitetit janë dy: 1. Bankat janë detyruar të mbajnë mjete likuide në sasi relativisht

të mëdha në pritje të vendimit të qeverisë së Kosovës për pagesën e dividendës, kështu që bankat janë të detyruara të kenë paratë në momentin që i kërkohen, 2. çështja e dytë është se ka pas një kursim të kreditimit në krahasim me vitin e kaluar. Përfundimisht unë mendoj që tani është e qartë që bankat do të jenë të kujdesshme, sepse i dinë detyrimet e tyre se si prapë duhet t'i kthejnë mjetet në buxhetin e Kosovës dhe dividendën e BQK- së. Mirëpo është inkurajues me gjithë faktin që mjetet t'i kthejnë sipas afatit që janë marrë vesh bankat dhe Qeveria, që prapë ka një rritje të depozitave që sillen mesatarisht në raport me vitin e kaluar rreth 18% dhe kryesisht janë depozita të qytetarëve. Në totalin e depozitave në sistem mbi 60% janë të qytetarëve, ndërsa kreditimi mbi 60% u jepen bizneseve, d.m.th. teprica e mjeteve qytetarëve ju shërben për financimin ekonomik. Diku 53, 54% të kredive kryesisht jepen në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve, kreditë në bujqësi janë në masën 4%, kështu që vijmë në një konkluzion ku sektori bankar realisht e ndan fatin e strukturës ekonomike të Kosovës, është faktor i ndryshimit të saj gradual por s'mund të jetë ndryshe sesa e kemi strukturën ekonomike në Kosovë.

Gani Gërguri (BQK) - Pyetja që shtroi z. Salihaj është kruciale për vetë vendin d.m.th. përdorimi i euros, vetë përdorimi i euros i determinon shumë çështjet të cilat i keni ngritur. Për ta pasur një euro duhet fituar atë euro, që është diçka krejt specifike në krahasim me shtetet të cilat emetojnë paranë e vet edhe krijojnë politika monetare dhe kreditore. Kjo i ka edhe të mirat edhe të këqijat e veta, por ne në analizat tona kur e kemi bërë bilancin përfundimtar kemi konstatuar se për një shtet të ri si i joni me një strukturë të tillë ka pas më shumë përparësi sesa dobësi. Ne faktikisht euron e përdorim në mënyrë unilaterale edhe kemi kosto për ta përdorë atë, çdo para që dëmtohet në qarkullim ne duhet për ta dërguar në eurozonë për ta ndërruar edhe për ta marrë euron e re, edhe dërgimi andej edhe prurja këndeje e ka koston e vet, gjë e cila nuk është me bankat e tjera.

Adem Salihaj – Çdo vend kur ka rritje ekonomike emiton para shtesë për aq sa ka rritje ekonomike, kurse ne s'mund të emitojmë para, nëse ne nuk eksportojmë jashtë që të marrim para, por e shesim brenda si e zgjidhim ne këtë problem?

Gani Gërguri (BQK) - E vetmja zgjidhje është emitimi indirekt, është rritja e prodhimit në vend rritja e eksporteve në vend, edhe tërheqja e investimeve të huaja direkt, të cilat Kosova faktikisht i ka këta parametra. Është një rrugë ma e vështirë por në afatgjatë është më e shëndetshme sesa rruga në të cilën emitohen para dhe shkaktohet ndonjë inflacion me qëllim të sigurimit të ndonjë rritje ekonomike, si alternative e mospasjes së emitimit të parasë është prodhimi vendor, eksporti i prodhimeve vendore.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

- 1. Të hartohen Rekomandimet për “Politikat bankare të BQK- së”, në bazë të diskutimeve në Komision;*
- 2. Formohet grupi punues për hartimin e Rekomandimeve në këtë përbërje: Myzejene Selmani, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Adem Salihaj dhe Qamile Morina.*

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210

Kryetarja – Fjalën ia dha kryetares së grupit punues për të paraqitur propozim-amendamentet për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210.

Sala Berisha – Shala - Kërkoj që shqyrtimi i këtij Projektligji të shtyhet për mbledhjen e radhës për shkak se ka disa vërejtje të disa Propozimamendamente deputetëve që janë bërë gjatë shqyrtimit në parim, të cilat janë substanciale, po ashtu ka amendamente të deputetit z. Riza Smaka, të cilat nuk janë shqyrtuar në takimin e Grupit punues.

Murselj Halilji – Kërkoj që të merren parasysh Propozimamendamentet e tij, të cilat nuk ka mundur t'i prezantojë në grup punues, por i ka drejtuar më shkrim.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210.

6. Të ndryshme

i) Monitorimi i Ligjit nr. 2002/7 për Telekomunikacionin

Kryetarja – I njoftoi se më 30.06.2010 do të realizohet një Takim zyrtar në PTK- në, gjithnjë në bazë të agjendës të grupit punues. Dhe njëherit i ftoj të gjithë deputetet që janë të interesuar të marrin pjesë në këtë Takim.

ii) Projektligjet e energjisë

Kryetarja – Kërkoj nga grupi punues të përgatitën në muajin korrik të këtij viti për amendamentimin e Projektligjeve të energjisë, sepse duke u bazuar në planin e punës së Komisionit është dashur që të procedohen deri më tani. Grupi punues për Projektligjet e energjisë ka këtë përbërje: Ethem Çeku, Myzejene Selmani, Adem Grabovci, Fatmir Rexhepi dhe Kaqusha Jashari.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 00

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani